

SËMUNDJET KARDIOVASKULARE

Sëmundjet kardiovaskulare janë shkaku kryesor i vdekjeve në rrafsh global, e që shkaktojnë më shumë vdekje se të gjitha shkaqet e tjera së bashku dhe kryesisht i prekin vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Në kuadër të sëmundjeve jo të transmetueshme sëmundjet kardiovaskulare së bashku me sëmundjet malinje përbëjnë pothuajse tre të katërtat e vdekshmërisë në rajonin evropian. Vlerësimet tregojnë se të paktën 80% e të gjitha sëmundjeve të zemrës, sulmit në zemër dhe diabetit të tipit 2 mund të parandalohen.

Çdo vit, sëmundjet kardiovaskulare janë shkaku i rreth 18 milionë vdekjeve të parakohshme, ndërsa deri në vitin 2030 pritet që nga këto sëmundje të vdesin 23,6 milionë njerëz. Këto janë parashikimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), me çrast pritet që SKV të bëhen shkaku kryesor i vdekjeve në mbarë botën.


Faktorët më të shpeshtë të rrezikut për shfaqjen e sëmundjeve kardiovaskulare janë përdorimi i duhanit, pasiviteti fizik, ushqimi jo i shëndetshëm dhe përdorimi i tepruar i alkoolit, që shkaktojnë katër ndryshime kyçe metabolike/fiziologjike: tension të lartë të gjakut, mbipeshë/obezitet, rritje të nivelit të sheqerit dhe kolesterolit në gjak. Një numër i madh i vdekjeve i atribuohen pirjes së duhanit, i cili rrit rrezikun e vdekjes nga sëmundjet koronare të zemrës dhe sëmundjet cerebrovaskulare për 2-3 herë. Rreziku rritet me moshën dhe është më i madh tek femrat sesa tek meshkujt.

GJENDJA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Mortaliteti

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2023 nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut kanë vdekur 8836 persona me një shkallë të vdekshmërisë prej 483,4 në 100.000 banorë, nga të cilët 4369 janë meshkuj, ndërsa 4467 janë femra. Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut marrin pjesë me 43,8% në mortalitetin e përgjithshëm dhe zënë vendin e parë në strukturën e shkaqeve të vdekjes.


Diagrami 1. Struktura sipas shkaqeve të vdekjes në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2023



Shkalla e mortalitetit nga sëmundjet e organeve të qarkullimit të gjakut në numrin e përgjithshëm të popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2010-2023


oscilon. Në vitin 2010 shkalla e mortalitetit ka qenë 538,6, ndërsa në vitin 2023 483,4 në 100000 banorë.

Diagrami 2: Mortaliteti nga sëmundjet e organeve të qarkullimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2010-2023




Shkalla specifike e mortalitetit sipas moshës nga sëmundjet e organeve të qarkullimit të gjakut tek popullata mbi 65 vjet është dukshëm më e lartë krahasuar me shkallën specifike të mortalitetit tek popullata nga 0-64 vjet.

Diagrami 3: Mortaliteti nga sëmundjet e organeve të qarkullimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas moshës, 2010-2023




Vdekshmëria nga sëmundjet ishemike të zemrës tek popullata mbi 65 vjet është dukshëm më e lartë krahasuar me mortalitetin tek popullata nga 0-64 vjet.

Diagrami 4: Mortaliteti nga sëmundjet ishemike të zëmres në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas moshës, 2010-2023




Shkalla e mortalitetit nga sëmundjet cerebrovaskulare tek popullata mbi 65 vjet në vitin 2023 ka qenë 553,7 në 100.000 banorë, ndërsa tek popullata deri në 64 vjet 19,4‰, nga çka vihet re se vdekshmëria është dukshëm më e lartë tek grupmosha mbi 65 vjet.

Diagrami 5: Mortaliteti nga sëmundjet cerebrovaskulare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas moshës, 2010-2023




Sipas gjinisë, në periudhën 2010-2023 mortaliteti nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut është më i lartë tek femrat se sa tek meshkujt.

Diagrami 6: Mortaliteti nga sëmundjet e organeve të qarkullimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas gjinisë, 2010-2023




Shkalla e vdekshmërisë nga sëmundjet ishemike të zëmrës në periudhën 2010-2023 është më e lartë tek meshkujt (diagrami 7), ndërsa shkalla e vdekshmërisë nga sëmundjet cerebrovaskulare gjatë gjithë periudhës së analizuar 2010-2022 është më e lartë tek femrat, ndërsa në vitin 2023 është më e lartë te meshkujt (diagrami 8).

Diagrami 7: Mortaliteti nga sëmundjet ishemike të zëmrës në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas gjinisë, 2010-2023




Diagrami 8: Mortaliteti nga sëmundjet cerebrovaskulare në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas gjinisë, 2010-2023



Në vitin 2023 në Republikën e Maqedonisë së Veriut infarkti akut i miokardit ka marrë pjesë me 88,4% në sëmundjet ishemike të zemrës, ndërsa infarkti cerebral dhe pika, i pashënuar si gjakderdhje ose infarkt me 91,3% në sëmundjet cerebrovaskulare.

Sipas të dhënave të bazës të të dhënave HFA të OBSH-së, shkalla e mortalitetit nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut në 100.000 banorë ka qenë 92,0 në Izrael, 113,0 në Danimarkë, 141,0 në Suedi, 165,0 në Gjermani, 170,0 në Greqi, 171,0 në Slloveni, 232,0 në Turqi, 372,0 në Hungari, 436,0 në Rumani, 506,8 në Maqedoni, 539,0 në Bullgari, etj. (të dhënat e fundit në dispozicion).

SDR, diseases of circulatory system, all ages, per 100 000



Burimi: HFA-DB, World Health Organization

PARANDALIMI DHE KONTROLLI

Bazuar në faktin se 80% e sëmundjeve të zemrës mund të parandalohen, në Republikën e Maqedonisë së Veriut po zbatohen masa të bazuara në fakte për parandalimin e faktorëve të rrezikut siç është përdorimi i duhanit, ushqimi jo i shëndetshëm, pasiviteti fizik dhe përdorimi i tepruar i alkoolit, detektimi në kohë i SKV, përmirësimi i mjekimit në nivel sekondar dhe terciar duke e përforcuar sistemin shëndetësor me kuadro, pajisje, duke i rikonstruktuar objektet e vjetra dhe duke ndërtuar objekte të reja spitalore dhe masa të tjera. Qëllimi kryesor është që t'i përgjigjemi ngarkesës gjithnjë e më të madhe që e ka popullata nga sëmundjet kardiovaskulare dhe të reduktohet invaliditeti dhe vdekshmëria nga këto sëmundje.

PARANDALIMI NË MBROJTJEN SHËNDETËSORE PRIMARE

Vitet e fundit në Republikën e Maqedonisë së Veriut rëndësi e veçantë i kushtohet promovimit të shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve në mbrojtjen primare shëndetësore. Zbatimi i masave dhe aktiviteteve preventive që kanë për qëllim përmirësimin e gjendjes shëndetësore të popullatës është një nga detyrimet ligjore të çdo mjeku të mbrojtjes shëndetësore preventive, si dhe të çdo mjeku amë. Në këtë drejtim, Instituti i Shëndetit Publik dhe 10 Qendrat e Shëndetit Publik, si dhe Shtëpitë e Shëndetit po punojnë në mënyrë aktive për realizimin e fushatave, edukimit nëpër shkolla, institucione shëndetësore dhe mjedise të tjera, përgatitjen dhe distribuimin e materialeve shëndetësore edukative, organizimin e aksioneve për kontrolle preventive falas, para së gjithash në zonat rurale, të gjitha me qëllim të ndërgjegjësimit të qytetarëve për t'u kujdesur për shëndetin e tyre.

Një pjesë e mjeteve që Fondi për Sigurim Shëndetësor të Maqedonisë (FSSHM) ua paguan mjekëve amë janë të dedikuara për zbatimin e masave dhe aktiviteteve preventive. Masat dhe aktivitetet preventive FSSHM i përcakton si qëllime preventive që zbatohen për personat e siguruar me qëllim të parandalimit të shfaqjes së sëmundjeve dhe u dedikohen atyre personave që e vizitojnë mjekun amë në mënyrë të parregullt. Mjekët e përgjithshëm të përzgjedhur zbatojnë katërmbëdhjetë qëllime parandaluese. Qëllimi 11 prej tyre thotë:

-Masa dhe aktivitete preventive për zbulimin e hershëm të sëmundjeve joinfektive kronike (VKV – vlerësimi kardiovaskular) tek popullata në moshë nga 25 deri më 65 vjet tek të dy gjinitë.

Për zbatimin e Qëllimit 11 u përgatitën tabela që i përmbajnë karakteristikat/parametrat e mëposhtëm: gjinia, moshë, përdorimi i duhanit, lartësia e trupit, lartësia e tensionit sistolik të gjakut, rezultatet laboratorike, sulme paraprake në zemër, goditje paraprake në tru, hipertrofi e ventrikulit të majtë e definuar me EKG dhe prania e diabetit. Për secilën nga karakteristikat/parametrat e dhënë (që janë edhe faktorë rreziku), përcaktohen pikët e duhura të cilat mbledhen dhe fitohet një numër total pikësh (SCORE). Pasi të jetë fituar numri i përgjithshëm i pikëve (SCORE), mund të përcaktohet shkalla e rrezikut nga sëmundjet kardiovaskulare. Me prezantimin e një qasjeje sistematike tek mjekët e përgjithshëm të përzgjedhur në MSHP për zbulimin në kohë të faktorëve të mundshëm të rrezikut dhe eliminimin e tyre, mund të parandalohet dukshëm shfaqja e manifestimeve urgjente kardiovaskulare (sulmi në zemër ose goditja në tru) dhe në këtë mënyrë të parandalohen vdekjet e parakohshme tek popullata.

Përgatiti:

Departamenti i promovimit të shëndetit dhe i ndjekjes së sëmundjeve